

HUMLUMTIMI : VËSHTRIMET E FËMIJËVE, PRINDËRVE DHE MËSUESVE PËR FENOMENIN E SJELLJEVE ANTISOCIALE (2009)

Ne kemi realizuar gjatë muajit nëntor një vëzhgim ku një pyetësor i hartuar nga ana e stafit të PMSH dhe i bazuar në versione tjera të ngjashme është dhënë për plotësim në shkolla-për nxënësit dhe arsimtarët dhe për prindër. Prindërit nuk kanë korresponduar me nxënësit që dmth se janë nga lagje të qytetit dhe nuk janë prindërit e nxënësve të përfshirë.

Nxënësit

Nxënësit janë të klasave 6,7,8,9 të shkollave; ku me zgjedhje rastësore është marrë vetëm një nxënës nga secila klasë me numrin 20 në ditë. Numri i nxënësve që kanë plotësuar pyetësorët ishte 319, prej tyre 244 ishin të shkollave fillore dhe 75 të dy shkollave të mesme. Meshkuj ishin 155 ndërsa femra 160, 4 nxënës nuk e kanë shënuar gjininë. 11 nxënës të shkollave fillore ishin nga fshati. Shqiptarë janë deklaruar 271, boshnjak 37, turk 1, ashkalinjë 1, romë 6 dhe në 3 raste nuk kemi të vendosur përkatësinë kombëtare. Moshë mesatare e tyre ishte 13,93.

Në pyetjen se: Sa keni mirëkuptim me anëtarët e familjes suaj? 94 % e nxënësve të shkollës fillore dhe 94,66 % e nxënësve të shkollës mesme janë deklaruar pozitivisht.

Në pyetjen A ka shpesh grindje në familjen tuaj? 55 % (fillore) dhe 42,66 % (mesme) e mohojnë këtë. Këtu ekziston edhe një dallim se dyfish më shumë femra të shkollës mesme e pohojnë këtë se sa meshkujt.

Në pyetjen se A merr pjesë ti në grindjet në familje? 40,98 % (fillore) dhe 53,33 % (mesme) e tyre pranojnë se përfshihen në zënkat në familje. Si duket sipas perceptimit tyre zënkat në familje nuk dmth. se mungon mirëkuptimi.

Në pyetjen A ndodh që zënkat familjare të kalojnë në dhunë fizike të ndonjë anëtar(e)? Vetëm 6,55 % (fillore) dhe 2,66 % (mesme) e nxënësve e konfirmojnë këtë.

Në pyetjen se Cilët janë shkaktarët që sjellin grindje në familjen tuaj? Vetëm 21,72 % (fillore) dhe 12 % (mesme) nuk përmendin shkaqe të zënkave që mund të merret ndoshta si numri më i besueshëm i familjeve pa grindje. Si arsye më të shpeshta për grindje numërohen – problemet me fëmijët 30,37 % ,dy e më shumë faktorë 25 % , materiale 13,11 % , dhe bashkëshortore 7,78 % tek shkolla fillore; ndërsa tek nxënësit e shkollës mesme- problemet me fëmijët 42,66 % , materiale 22,66 % .

Në pyetjen se A konsumohet alkooli në familjen tuaj? 81,14 % (fillore) dhe 76 % (mesme) e kanë mohuar këtë.

Në pyetjen Si ndëshkohesh në rast të ndonjë gabimi? nxënësit e shkollës fillore 75,4 % e kanë përmendur këshillën, 5,73 % ofendimin, 9% kufizimin e gjërave, 4% rrahjen dhe 2,45 % më tepër se një mënyrë. Nxënësit e shkollës së mesme – 80 % e kanë përmendur këshillën, 6,66 % ofendimin, 5,33 % kufizimin e gjërave dhe 6,66 % rrahjen. Edhe tek nxënësit nga fshati metoda e këshillës dominon me 63,63 %.

Në pyetjen se Si ndëshkohesh nga arsimtari në rast të ndonjë gabimi? nga 264 mënyra të konstatuara nga nxënësit e fillores më e shpeshta me 35,77 % ishte vërejtja, pastaj 26,51 % thirrja e prindit, ofendimi 12,87 % , ulja e notës në 9,46 % ,largimi nga ora 6,81%, ulja e notës sjelljes 5,68 % , rrahja në 3,78 % etj. Dy e më shumë mënyra kemi pasur tek 9 % e rasteve. Nga nxënësit e shkollave të mesme kemi përdorimin e vërejtjes në 47,43 % të rasteve, largimi nga ora në 20,51 % , thirrja e prindit 14,1 % , ulja e notës sjelljes 5,68 % , ofendimi 3,84 % etj. por asnjëherë rrahja. Dallimi ekziston tek rasti i nxënësve në shkollat e fshatit ku 63,63 % e kanë përmendur ofendimin si mënyrë ndëshkimi edhe këtu rrahjen nuk e konstatojnë asnjë prej nxënësve.

Në pyetjen se A ndodh që dënohesh edhe kur s'ke faj? nxënësit e shkollave fillore përgjigjen me- kurrë- në 45,90 % të rasteve, ndonjëherë -49,59 %,shpeshherë 4,50 % ; kurse ata të shkollave të mesme – kurrë- në 41,33 %, ndonjëherë – 49,33 % , shpeshherë 9,33 %.

Në pyetjen Për çfarë arsye dënohesh?në familje; nxënësit e shkollave fillore përgjigjen se në 37,98 % të rasteve është prishja e qetësisë, grindjet me vëlla/motër 18,21 %, pa arsye 11,62 %, gabimet e përsëritura 8,52 %, se rri me shoqëri të mirë 6,58 %, dëme materiale 4,65 % etj kurse në 5,03 % të rasteve më shumë se një mënyrë. Nxënësit e shkollave mesme përgjigjen se në 38,96 % të rasteve është prishja e qetësisë, grindjet me vëlla/motër 9,09 %, pa arsye 18,18 %, gabimet e përsëritura 9,09 %, se rri me shoqëri jo të mirë 7,79 %, dëme materiale 6,49 % etj .

Në pyetjen A ju ka ofenduar ndonjëherë ndokush në shkollë apo jashtë saj? 52,98 % e nxënësve të shkollave fillore kanë deklaruar jo dhe përqindje të ngjashme kanë edhe nxënësit e shkollave të mesme.

Në pyetjen A jeni kërcënuar ndonjëherë me rrahje? 83,19 % e nxënësve të shkollave fillore kanë deklaruar jo kurse kjo përqindje tek nxënësit e shkollave të mesme është 74,66 %.

Në pyetjen A jeni kërcënuar ndonjëherë me armë zjarri ose të ftohta? vetëm 2,86 % e nxënësve të shkollave fillore e kanë pranuar këtë kurse tek nxënësit e shkollave të mesme është 6,66 %.

Në pyetjen A ju ka kërkuar ndokush para me forcë në shkollë? vetëm 6,96 % e nxënësve të shkollave fillore e kanë pranuar këtë kurse tek nxënësit e shkollave të mesme është 2,66 %.

Në pyetjen A ju ka detyruar ndokush të punoni ose të bëni diçka pa dëshirë ? 7,37 % e nxënësve të shkollave fillore i kanë pohuar që është më e vogël se ajo e nxënësve të shkollave të mesme që arrin në 10,66 %.

Në pyetjen A ju ka urdhëruar ndokush të dëmtoni ndonjë gjë? pohimi vjen nga 3,68 % e nxënësve të shkollave fillore dhe 5,33 % e atyre të shkollave të mesme.

Në pyetjen A ju ka rrahur ndonjëherë ndokush? 48,36 % e nxënësve të shkollave fillore përgjigjen pozitivisht dhe 13,3 % të nxënësve të shkollave të mesme.

Në pyetjen A keni pasur ngacmime seksuale ndonjëherë në shkollë ose në rrugë? 93,44 % janë deklaruar jo tek nxënësit e shkollës fillore dhe 93,33 % e nxënësve të shkollave të mesme.

Në pyetjen Për çdo padrejtësi që është bërë ndaj jush a e ke lajmëruar ndokënd? 23,25 % janë deklaruar se nuk kanë lajmëruar askend,54,65 % prindin,18,99 arsimtarin dhe 2,71 % policinë. Ndërsa nxënësit e shkollave të mesme 50,66 % prindin, 33,33 % askend,13,33 % arsimtarin dhe 2,66 % policinë.

Në pyetjen Nëse nuk i ke lajmëruar padrejtësitë ndaj jush, për çfarë arsye e keni bërë këtë? 29 % e nxënësve të shkollave fillore deklarojnë se nuk ju ka duk serioze,27,45 % nga frika,12,29 % nga turpi, 6,96 % nuk kanë pasur besim, 5,73 % nuk kanë ditur kujt, 4,91 % janë frikësuar se nuk ju besojnë etj. Nxënësit e shkollave të mesme në 32,46 % nuk e kanë marrë seriozisht, 12,98 % kanë pasur frikë, 11,68 % nga turpi, 10,38 % nuk kanë ditur se kujtë etj.

Në pyetjen A keni qenë prezentë në ndonjë situatë të dhunshme, plaçkitje apo ngacmime seksuale ndaj dikujt tjetër? 19,67 % e nxënësve të shkollave fillore kanë pohuar këtë dhe 25,33 % e nxënësve të shkollave të mesme.

Në pyetjen Nëse keni qenë prezentë, çfarë masa keni ndërmarrë? nuk janë përgjigjur 36,47 % e nxënësve të shkollave fillore, prej atyre që janë përgjigjur 22,4 % nuk kanë bërë asgjë, 14,4 % e kanë lajmëruar policinë, 12,8 % arsimtarin ose drejtorin, 8,4 % prindin etj. 34,66 % e nxënësve të shkollave të mesme nuk janë përgjigjur, 34,66 % nuk kanë ndërmarr asgjë, 18,66 % policinë etj.

Në pyetjen A ndodh që ndonjë punëtor i shkollës i fyen dhe ofendon nxënësit? 74,36 % e nxënësve të shkollave fillore janë deklaruar jo, në 9,42 % këtë e bën arsimtari, 6,55 % stafi teknik, 6,14 % disa prej tyre, 1,22 % drejtori, 3,27 % nuk janë përgjigjur fare. 62,66 % e nxënësve të shkollave të mesme deklarohen me jo, arsimtari dhe dy e më shumë janë në 13,33 % të rasteve, stafi teknik në 5,33 % etj.

Në pyetjen A ndodh që ndonjë punëtor i shkollës të përdorë dhunë fizike ndaj nxënësve? 81,96 % e nxënësve të shkollave fillore deklarohen kundër, 9,83 % e rasteve arsimtari përdor dhunën fizike, 2 % përmendin dy e më tepër persona. 73,33 % e nxënësve të shkollave të mesme deklarojnë jo, 9,33 % dy e më shumë, 6,66 % stafi teknik etj.

Në pyetjen A ju ka rrahur ndokush juve? 76,63 % e nxënësve të shkollave fillore deklarojnë se nuk ju ka ndodhur, 19,67 % arsimtarin, 0,81 % drejtorin. 81,33 % e nxënësve të shkollave të mesme deklarojnë jo, 9,33 % e akuzojnë arsimtarin etj.

Në pyetjen A keni njohuri që dikush nga nxënësit mban armë në shkollë? 22,13 % e nxënësve të shkollave fillore përgjigjen po, 73,36 % jo dhe 4,50 % nuk përgjigjen fare. 17,46 % e nxënësve të shkollave të mesme përgjigjen po, 76,92 % jo dhe 6,15 % nuk përgjigjen fare.

Në pyetjen A e keni informuar dikë për këtë? 47,61 % e nxënësve të shkollave fillore përgjigjen jo, 30 % nuk japin përgjigje fare etj. Poashtu 70,66 % e nxënësve të shkollave të mesme përgjigjen me jo.

Në pyetjen Personat e lajmëruar nga ti a kanë marrë ndonjë masë për këtë? Vetëm 11 % e nxënësve të shkollave fillore janë deklaruar po, kurse 35,24 % nuk e di, 25 % jo dhe 28,68 % nuk janë përgjigjur. 10,66 % e nxënësve të shkollave të mesme deklarohen po, 34,66 % nuk e di, 25,33 % jo dhe 29,33 % nuk janë përgjigjur.

Në pyetjen A janë ndëshkuar ata fëmijë për këtë vepër? 30,32 % e nxënësve të shkollave fillore mendojnë se po, 21,72 % jo, 15,57 % thonë se nuk janë paraqit më, 32,37 % nuk janë përgjigjur fare. 24 % e nxënësve të shkollave të mesme mendojnë se po, 9,42 % jo, 9,33 % nuk janë paraqitur më dhe 36 % nuk janë përgjigjur fare.

Mësimdhënësit

Pyetësorët e përshtatur për mësimdhënësit janë plotësuar nga 100 arsimtarë dhe profesor; nga të cilët 50 janë meshkuj, 49 femra dhe një rast nuk e ka shënuar gjininë. Për nga përkatësia kombëtare 14 % janë boshnjakë dhe të tjerët shqiptarë. Për nga vendbanimi 7 % janë nga fshati dhe 93 % nga qyteti. Për nga përgatitja shkollë 4 % janë me shkollë normale, 56 % me shkollë të lartë, 36 % me fakultet dhe 4 % nuk e kanë shënuar përgatitjen shkollë.

Në pyetjen Si i ndëshkoni nxënësit në rast të ndonjë gabimi? 97 % e tyre kanë deklaruar se e përdorin këshillimin, 12 % mbikëqyrjen e shtuar etj. Kjo nuk ka pasur dallim as në bazë të përkatësisë gjinore, as kombëtare dhe as vendbanimit.

Në pyetjen se A ndodh që ta ndëshkoni nxënësin edhe kur nuk ka faj? 84 % deklarohen se kjo nuk ndodhë kurrë kurse 14 % se ndonjëherë e bëjnë këtë.

Në pyetjen Për çfarë arsye e ndëshkoni nxënësin? në 41 % të rasteve përmendet prishja e qetësisë, 27,58 % gabimin e përsëritur, 14,48 % dëmtimet materiale, 12,41 % mosmësimin, 8,27 % grindjet, 4,13 % gënjeshtrenë dhe 2 % nuk janë përgjigjur.

Në pyetjen A është ankuar nxënësi që është ofenduar ndonjëherë nga ndokush në shkollë apo jashtë saj? 56 % e tyre e kanë pohuar këtë gjë. Ka një dallim se mësimdhënësit boshnjak në 64,28 % rasteve e kanë mohuar këtë.

Në pyetjen se A është ankuar nxënësi që është kërcënuar ndonjëherë me rrahje? 47 % e mësimitdhënësve e kanë pohuar këtë.

Në pyetjen se A ju është ankuar ndonjëherë nxënësi që i ka kërkuar ndokush para (gjësende tjera) me forcë në shkollë? 82 % e tyre janë përgjigjur me jo.

Në pyetjen se A ka ndodhur ndonjëherë që nxënësit të dëmtojnë ndonjë gjë në shkollë? 93 % e tyre janë përgjigjur pozitivisht.

Në pyetjen se A ka pasur rrahje ndonjëherë në shkollë? 67 % e tyre e kanë pohuar këtë.

Në pyetjen se A ka parë nxënësi juaj ndonjë situatë të dhunshme (plaçkitje apo ngacmime seksuale ndaj dikujt tjetër)? 42 % kanë deklaruar se nuk e dinë këtë, 41 % me jo, 15 % po dhe 2 % nuk janë përgjigjur fare.

Në pyetjen se Nëse ju ka treguar nxënësi, çfarë masa keni ndërmarrë ju? nga 110 masat e ndërmarra 40,90 % e kanë lajmëruar drejtorin, 31,81 % nuk janë përgjigjur fare, 21,81 % prindin, 4,54 % policinë, 1,81 % nuk kanë ndërmarr asgjë dhe asnjë rast nuk kanë deklaruar të jenë frikësuar.

Në pyetjen se A ndodh që ndonjë punëtor i shkollës i fyen dhe ofendon nxënësit? 72 % e tyre e kanë mohuar këtë, 8 % e përmendin arsimtarin, 8 % disa prej tyre, 7 % stafin teknik, 4 % nuk janë përgjigjur dhe 1 % drejtorin.

Në pyetjen A ndodh që ndonjë punëtor i shkollës të përdorë dhunë fizike ndaj nxënësve? 91 % e mohojnë këtë, 6 % arsimtarin etj.

Në pyetjen se A rrihen nxënësit nga ana e stafit të shkollës? 90 % e mohojnë këtë, 10 % arsimtarët etj.

Në pyetjen se A keni njohuri që dikush nga nxënësit mban armë në shkollë? 18 % e pohojnë këtë.

Në pyetjen se A e keni informuar dikë për këtë? 40 % deklarojnë se nuk e kanë bërë këtë, 18 % drejtorin, 6 % policinë, 36 nuk janë përgjigjur.

Në pyetjen se Personat e lajmëruar nga ju a kanë marrë ndonjë masë për këtë? 36 % nuk janë përgjigjur, 29 % nuk e di, 21 % po dhe 14 % jo.

Në pyetjen se A janë ndëshkuar ata fëmijë për këtë vepër? 44 % nuk janë përgjigjur, 40 % po, 13 % jo dhe 3 % nuk janë paraqit më në shkollë.

Prindërit

Kemi mundur të marrim përgjigjet nga 254 prindër të zgjedhur rastësisht në lagjet e tyre. Për nga nacionaliteti shqiptarë ishin 216 ose 85,13 %, boshnjakë 14 ose 5,51 %, turq 9 ose 3,54 %, ashkalinjë dhe romë nga 6 ose nga 2,36 % si dhe 3 raste nuk e kanë deklaruar këtë. Për nga përgatitja shkollore 46,45 % kanë rezultuar me shkollë të mesme, 29,92 % me shkollë të lartë, 16,92 % me shkollë fillore, 4,72 % analfabet dhe 1,96 % nuk janë deklaruar fare.

Në pyetjen se A ka ndonjë problem në familjen tuaj? 45,66 % e tyre mohojnë të kenë probleme, 28,34 % deklarojnë se kanë mirëkuptim, 15,35 % afirmojnë problemet me fëmijët, 8,66 % se nuk pajtohen me anëtarë tjerë dhe 2,75 % se nuk kuptohen me asnjë anëtarë të familjes.

Në pyetjen se A ka shpesh grindje në familjen tuaj? 55,90 % përgjigjen ndonjëherë, 33,46 % jo, 8,66 % shpeshherë dhe 1,96 % gjithnjë.

Në pyetjen se Cilët janë shkaktarët që sjellin grindje në familjen tuaj? Nga përgjigjet kemi këto përqindje: shkaqet materiale 46,45 %, fëmijët 17,32 %,një e më shumë faktorë 14,56 %, nuk kanë dhënë përgjigje 8,66 %, problemet bashkëshortore 7,08 % dhe alkooli 5,90 %.

Në pyetjen se A ndodh që zënkat familjare të kalojnë në dhunë fizike të ndonjë anëtarit? 13,38 % deklarojnë se po, 18,50 % ndonjëherë, 68,11 % jo.

Në pyetjen se A merr pjesë ti në grindjet në familje? 33,85 % përgjigjen me kurrë, 44,88 % ndonjëherë, 10,23 % shpesh, 9,44 % gjithnjë.

Në pyetjen se A konsumohet alkooli në familjen tuaj? 51,18 % e mohojnë këtë, 34,64 % deklarojnë ndonjëherë ,8,66 % shpeshherë, 3,14 % gjithnjë etj.

Në pyetjen se Si e ndëshkoni ju fëmijën tuaj në rast të ndonjë gabimi? 53,12 % e përmendin këshillimin, 12,50 % ndalimin e gjërave, 10,31 % mbikëqyrjen e shtuar, 7,5 % rrahjen, 4,68 % ofendimin, 9,68 % mbi një mënyrë si dhe 2,18 % nuk përgjigjen fare. Në 58,33 % të rasteve rrahjen e përdorin femrat. Në 45,83 % të rasteve rrahja është përdorur nga prindër me fillore.

Në pyetjen se A ndodh që ta dënoni fëmijën tuaj edhe kur nuk ka faj? 60,62 % përgjigjen se kjo nuk ndodh kurrë, 33,85 % se kjo ndodhë ndonjëherë, 3,14 % shpeshherë etj.

Në pyetjen se Për çfarë arsye e dënoni fëmijën tuaj? 22,44 për prishje të qetësisë, 20,07 % për grindjet, 17,32 % më shumë se një metodë, 11,41 % për një gabim të përsëritur, 8,66 % për një shoqëri jo të mirë, 7,87 % sepse gënjen, 6,29 % për dëmet e shkaktuara etj.

Në pyetjen se A është ankuar fëmija juaj që është ofenduar ndonjëherë nga ndokush në shkollë apo jashtë saj? 42,12 % përgjigjen po, 52,36 % jo dhe 5,51 % nuk janë përgjigjur fare.

Në pyetjen se A është ankuar fëmija juaj që është kërcënuar ndonjëherë me rrahje? 24,40 % janë përgjigjur pozitivisht, 70,47 % jo dhe 5,11 % nuk janë përgjigjur.

Në pyetjen se A ju është ankuar ndonjëherë fëmija juaj që i ka kërkuar ndokush para me forcë në shkollë? 12,59 % përgjigjen pozitivisht, 81,49 % negativisht dhe 5,90 % nuk janë përgjigjur.

Në pyetjen se A keni dëgjuar që fëmija juaj të ketë dëmtuar ndonjë gjë? 23,62 % e tyre përgjigjen pozitivisht.

Në pyetjen se A është rrahur ndonjëherë fëmija juaj nga ndokush? 32,24 % përgjigjen pozitivisht, 6,69 % nuk përgjigjen fare dhe 61,02 % jo.

Në pyetjen se Për çdo padrejtësi ndaj fëmijës suaj, a e ke lajmëruar ndokënd? 53,14 % nuk e kanë bërë këtë, 33,46 % arsimtarin, 7,08 % policinë, 1,57 % dy e më shumë persona.

Në pyetjen se Nëse nuk i ke lajmëruar padrejtësitë ndaj fëmijës suaj, për çfarë arsye e keni bërë këtë? 33,85 % përgjigjen se nuk ju ka dukë shumë serioze, 21,25 % nuk janë përgjigjur, 15,35 % nuk e kanë ditur se kujt me ju drejtu, 12,99 % nuk ka besuar në askënd, 9,84 kanë ndier turp, 6,29 % kanë pasur frikë.

Në pyetjen A ka parë fëmija juaj ndonjë situatë të dhunshme (plaçkitje apo ngacmime seksuale ndaj dikujt tjetër)? 21,65 % janë përgjigjur pozitivisht, 6,29 % nuk janë përgjigjur fare etj.

Në pyetjen se Nëse ju ka tregua fëmija, çfarë masa keni ndërmarrë ju? 33 % janë përgjigjur se nuk kanë ndërmarrë asgjë, 20,86 % nuk janë përgjigjur, 17,32 kanë lajmëruar prindin, 15,35 % arsimtarin ose drejtorin, 6,29 % policinë etj.

Në pyetjen se A ndodh që ndonjë punëtor i shkollës i fyen dhe ofendon nxënësit? 48,81 % deklarojnë jo, 16,92 % mendojnë se këtë e bëjnë shumë prej tyre, 13,77 mendojnë në stafin teknik, 10,62 % arsimtari, 1,18 % drejtori dhe 8,66 nuk janë përgjigjur fare.

Në pyetjen se A ndodh që ndonjë punëtor i shkollës të përdorë dhunë fizike ndaj nxënësve? 60,23 % deklarojnë jo, 14,96 % arsimtari, 8,66 % shumë prej tyre, 7,87 % nuk janë përgjigjur, 7,08 % stafi teknik dhe 0,78 % drejtori.

Në pyetjen se A e ka rrahur ndokush fëmijën tuaj? 66,14 % përgjigjen jo, 18,50 % arsimtari, 5,90 % nuk janë përgjigjur fare, 4,72 % shumë prej tyre, 3,14 % drejtori dhe 1,57 % stafi teknik.


Në pyetjen se A keni njohuri që dikush nga nxënësit mban armë në shkollë? 30,70 % janë përgjigjur pozitivisht, 61,41 % jo dhe 7,87 % nuk janë përgjigjur.

Në pyetjen se A e keni informuar dikë për këtë? 58,66 % janë deklaruar me jo, 13,38 % nuk janë përgjigjur fare, 8,66 % arsimtarin, 8,26 % policinë, 5,51 % drejtorin, 5,11 % kanë pasur frikë dhe 0,39 % dy e më shumë.

Në pyetjen se Personat e lajmëruar nga ti a kanë marrë ndonjë masë për këtë? 60,62 % kanë deklaruar se nuk e dinë, 15,74 % nuk janë përgjigjur fare, 16,92 % nuk kanë ndërmarrë asgjë dhe 6,69 % po.

Në pyetjen se A janë ndëshkuar ata fëmijë për këtë vepër? 66,5 % janë përgjigjur se nuk janë paraqitur më në shkollë, 13,77 % nuk janë përgjigjur fare, 11,02 janë përgjigjur me jo dhe 8,66 % me po.

Përgjigjet në pyetjen mbi rrahjen e fëmijës në shkollë nga stafi sipas përqindjes



Përgjigjet në pyetjen mbi pranin e armëve tek nxënësit në shkollë sipas përqindjes

